



MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 246, dt. 18.12.2015

Në mbështetje të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.12.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të rishikuar “Rikualifikim urban, blloku i kufizuar mes rrugëve “Dervish Hima”, “Sheh A. Pazari” dhe stadiumi “Qemal Stafa”, Tiranë (Investim që do të zhvillohet në rrugicën midis objekteve të Pallatit të Kongreseve dhe Hotel Rogner) me këto kushte:
 - *Trupi i rrugës së re të jetë 14m nga faqja veriore e objektit monument kulture “Pallati i Kongreseve”, kategoria e II-të.*
 - *Distanca të përcaktohet nga faqja veriore e objektit në kuotën e katit përdhe.*
 - *Projekti të plotësohet me detaje të lidhjes së kuotës së rrugës me shkallët ekzistuese në faqen veriore të objektit Pallati i Kongreseve.*
 2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI